

UNMIK/RREG/2007/3  
12 janar 2007

---

**RREGULLORE NR. 2007/3**

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2006/12 MBI  
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E  
NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999) mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut,

Duke ditur se paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut është organ i përkohshëm i themeluar për periudhën e kufizuar kohore të mandatit të UNMIK-ut,

Me qëllim të zbatimit efikas të panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut në këtë fazë të mandatit të UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si vijon:

Ndryshim

Neni 5.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 ndryshohet si vijon:

Anëtarët emërohen për një mandat njëvjeçar. Emërimi mund të vazhdohet për mandat (e) të mëtejshme varësisht nga ndonjë vendim i Këshillit të Sigurimit lidhur me mandatin e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 2  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 12 janar 2007.

Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm